ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Agjencioni Veterinarisë dhe Ushqimit

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 40800-21-858-1-3-6

Sa i përket tenderit për Furnizim me pajisje telekomunikuese

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

MEDIATECH&PRINT SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

TREGU ME SHUMICE TE AMORTIZERAT - PRISHTINE
(Adresa)

PRISHTINE — *10 000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

049 589 845 —
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

NEXHMEDIN NEZIRI
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@mediatech-print.com
(Adresa elektronike)

03.05.2021
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

Shoqëri me përgjegjësi kufizuar MEDIATECH & PRINT 3 Prishtinë

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi per kontrate eshte bere me date : 26.02.2021 *Hapja e tenderit eshte bere me date : 08.03.2021 ora 11:00* *Letrat standarde mbi vendimin eshte bere me date : 14.04.2021* *Kriteret e Dhënies : Tenderi i përgjegjshëm me* ***Çmimin më të ulët*** *Kerkes per rishqyrtim eshte bere me date : 16.04.2021* *23.04.2021 08:33 Shqyrtimi i kerkeses per rishqyrtim*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

HAPJA E TENDERIT ESHTE BERE ME DATE : 08.03.2021 ORA 11:00

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] ***Jo*** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Me datë **14.04.2021** autoriteti kontraktues **AUV** ka nxjerr vendimin e autoritetit kontraktues përmes formularit standard dhe letrën standarde mbi tenderuesit e eliminuar përmes formularit B42 ku Operatori ekonomik **Mediatech&Print sh.p.k** është shpallur i pa përgjegjshëm me arsyetimin si ne vijim, arsyetim i cili nuk qëndron i bazuar ne Ligjin për Prokurim Publik dhe Rregullat dhe Udhëzuesin për Prokurim Publik-RRUOPP.

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Tenderi i juaj është refuzuar sepse ju si operator ekonomik nuk i keni plotësuar kërkesën mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale sepse nuk keni dorëzuar katalogët me specifikimet e detajuara teknike sipas Kërkesës I të dosjes së tenderit. Katalogët me specifikime teknike te detajuara për produktet te cilat ofertoni. Ju lutem qe te hijezohen specifikat e ofruara për produkte e ofertuara ne mënyre qe të jetë sa me e qartë gjatë vlerësimit për krahasimin me specifikimet e kërkuara. Dëshmia 1. Katalogët e produkteve te ofertuar.

Operatori Ekonomik **Mediatech&Print sh.p.k** pas marrjes se letrës standarde mbi njoftimin e tenderuesit te eliminuar dhe vendimin e autoritetit kontraktues te datës **14.04.2021**, ku nuk jemi pajtuar me arsyet e eliminimit dhe me datë **16.04.2021** kemi bërë Kërkesën për Rishqyrtim sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe te cilën e kemi dërguar tek autoriteti kontraktues **AUV**.Përmes Kërkesës për Rishqyrtim Operatori ekonomik **Mediatech&Print sh.p.k** ka paraqitur dëshmitë dhe faktet qe arsyetimi i autoritetit kontraktues- **AUV** për eliminim te Operatorit Ekonomik **Mediatech&Print sh.p.k** është i pa bazuar dhe ne kundërshtim te plotë me Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe ligjet tjera ne fuqi.

Gjithashtu ne me date **16.04.2021** Kemi shfrytezuar te drejten tone duke bere **kerkesen per ri-shqyrtim** autoritetit kontraktues AUV dhe AK-AUV me date **23.04.2021** na ka kthyer shqyrtimin e kerkeses te cilen na ka kthyer ne menyre negative dhe na ka refuzuar duke mos respektuar ligjin e prokurimit dhe nenet e ligjit ku ne i kemi dokumentuar ne menyre te kjarte te gjitha qe AK ka bere shkleje ligjore dhe ka bere diskriminim ne dhenien e kontrates nje OE me te shtrejt me cmim.

pajisje telekomunikuese me numer te e-prokurimit 40800-21-858-1-3-6.

VENDIM

MBI REFUZIMIN E ANKESËS SË PARASHTRUAR NGA MEDIATECH & PRINT SH.P.K, të dorëzuara nëpër mjet e-prokurimit, me datën 16.04.2021, SI TË PABAZUAR.

I. Refuzohen kërkesa për rishqyrtim të MEDIATECH & PRINT SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Kontrate publike për Furnizim me pajisje telekomunikuese me numër të e-prokurimit 40800-21-858-1-3-6 të iniciuar nga AK Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë me datën 26.02.2021

II. Vërtetohet njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues – Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Kontrate publike për Kontrate publike për Furnizim me pajisje telekomunikuese me numër të e-prokurimit 40800-21-858-1-3-6, te iniciuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë me datën 26.02.2021.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

- **LEGJISLACIONI SEKONDAR/** Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP).

Neni 39.8 AK duhet të dërgojë "Kërkesë për sqarim të tenderit" OE përmes sistemit të prokurimit elektronik, dhe OE duhet të dorëzojë përgjigjen e tyre tek AK në një dokument të shkruar me anë të sistemit elektronik.
Neni 41 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 47 Informata sqaruese ose shtesë paragrafët 47.11,47.12,47.13,47.16,47.17,47.18,47.19,47.20,47.21,47.22,47.23

- **Ligji Nr. 04/L-223 – PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 PËR ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 04/L-102 Ligji Nr. 04/L-223 – PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 PËR ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 04/L-102**

UDHËZIMI ADMINISTRATIV Nr. 15 /2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.
   - Përmes vlerësimit jo te drejtë dhe eliminimit nga aktiviteti i prokurimit te Operatorit Ekonomik **Mediatech&Print sh.p.k**, AK- **AUV** ka kufizuar konkurrencën duke tentuar te eliminoje pa te drejte dhe jo konform me ligjin e prokurimit dhe keshtu mos ju jep rast për ofertime te metutjeshme dhe ketë mënyrë do te kemi mos efikasitet dhe transparenc ne shpenzimin e fondeve publike.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do t'i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

- Përmes vlerësimit jo te drejtë dhe eliminimit nga aktiviteti i prokurimit te Operatorit Ekonomik **Mediatech&Print sh.p.k** AK- **AUV** ka bërë diskriminim dhe trajtim jo te barabartë te ofertuesve duke eliminuar konkurrencën dhe transparencën qe janë parimet kryesore te Ligjit për Prokurim Publik.

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

1. Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave.

2. Paragrafi 2 i nenit 59 te LPP-se ne mënyrë shumë te çartë e thekson, citat paragrafi "***Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues. AK-*** **AUV** ***nuk ka zbatuar ketë paragraf dh ene ketë mënyrë ka bërë shkelje te LPP-se.***

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkese, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në këtë

nen.

- Përmes këtij vlerësimi AK- **AUV** duke na eliminuar ne si Operator Ekonomik **Mediatech&Print sh.p.k**,dhe mos zbatim te nenit 69 te LPP-se ka bërë shkelje serioze te dispozitave ligjore të LPP-së.

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje te rëndë te nenit 72 te LPP-se sepse ky nen ne mënyrë shumë të çartë e specifikon se kur dokumentacioni mund te jetë jo i plotë ose i gabuar ose kur mungojnë dokumentet autoriteti kontraktues mund te kërkojnë nga operatoret ekonomik qe te dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë dokumentacionin e duhur, citat paragrafi 1 i nenit 72 "***Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës"***

2. Po ashtu shkelje është bërë ne paragrafin 2 te nenit 72 te LPP-se, ***citat paragrafi "Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji". Arsyeja për te cilën ne jemi kualifikuar si te pa përgjegjshëm është kërkesë mbi mundësit teknike dhe profesionale e bazuar ne nenin 69 te LPP-se. dhe Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar sqarimet shtesë sipas paragrafit 2 te nenit 72 te LPP-se.***

3. Shkelje tjetër e rëndë nga autoriteti kontraktues është paragrafi 3 i nenit 72 te LPP-se, citat paragrafi "***Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.***

Paragrafi 3 i nenit 72 te LPP-se ne mënyrë shumë të çartë e specifikon se sigurimi i informacioneve shtesë aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e te cilave është fiksuar para skadimit te afatit për dorëzim te tenderëve dhe mund te verifikohet ne mënyrë objektive qe është në përputhje te plotë me ligjin qe ne i kemi dorëzuar tek autoriteti kontraktues me rastin e ofertimit.

- **LEGJISLACIONI SEKONDAR/** Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik,(RRUOPP).

- Neni 39 i RRUOPP Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformës elektronike.

- Neni 39.3 i RRUOPP, thotë, citat paragrafi "***Megjithatë, lejohet qe një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, te cilat mungojnë ne aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, ne mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit te Njoftimit për kontrate".***

Ne ketë rast i bëjmë pyetje AK- **AUV** pse nuk mund te ofrohen provat e mjaftueshme ne harmoni me ketë paragraf kur duhet shumë çartë se te gjitha faturat janë te lëshuara para datës se publikimit te njoftimit për kontratë. Kjo paraqet shkeljen e radhës nga AK- **AUV**

- Neni 39.5, citat paragrafi "39.5 ***Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 te LPP-se d.m.th dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, certifikatat e kualitetit, kërkesat e grupeve te OE.***

E njëjta pyetje vlen përsëri për AK- **AUV** pse nuk janë kërkuar sqarimet shtesë kur kemi te bëjmë me dispozitë shumë te çartë ligjore se mund te qartësohen te gjitha dokumentet qe janë dorëzuara ne pajtim me nenet 65-71 te LPP-së. Kjo paraqet tjetër shkelje ligjore nga AK- **AUV**

Bazuar në përshkrimin e mësipërm dhe dispozitat ligjore te lartcekura te LPP-se dhe Ligjeve tjera ne fuqi konstatojmë se AK- **AUV** ka bërë shkelje serioze te ligjeve te lartcekura duke na eliminuar neve si operator ekonomik nga ky aktivitet i prokurimit.

Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) qe sipas dispozitave ligjore te Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, te aprovoj ankesën tonë si të **BAZUAR** dhe të kthejë lëndën në **RIVLERËSIM.**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Përmes eliminimit nga ky aktivitet i prokurimit Operatorit Ekonomik **Mediatech&Print sh.p.k** i është shkaktuar dëmi si ne aspektin material dhe moral:

- Marzha e Fitimit te humbur
- Kostoja e përgatitja e dosjes se tenderit
- Kostoja e përgatitjes se kerkeses per ri-shqyrtim dhe Ankesa ne OSHP si dhe
- Shpenzime tjera administrative

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*